

Twenty-Ninth International Seminar for Albanian Language, Literature and Culture. Prishtina: University of Prishtina. 2008. 319-322

Sistemi nominal i gjuhës shqipe nga pikëpamja ballkanistike

Victor Friedman

Universiteti i Çikagos

Sistemi nominal i gjuhës shqipe zë një vend qendror në gjuhësinë ballkanike qysh nga fillimet e kësaj shkence. Siç dihet, Kopitari (1829) mori nyjat e prapavendosura në gjuhën shqipe, në gjuhët romane dhe sllave të Ballkanit, si një nga shenjat e para të ballkanizimit të sistemeve gramatikore të këtyre gjuhëve. Edhe në bazë të faktit se një nyjë e tillë nuk ekziston në gjuhët romane dhe sllave jashtë Ballkanit, dmth. jashtë Ballkanit linguistik, supozohet se ky fenomen vjen nga gjuha apo gjuhët që fliteshin në Ballkan para ardhjes së romakëve. Edhe në bazën e toponimit të vjetër *Drobeta*, sot Turnu Severin në Rumani, që sipas E. Hampit (1982:79) përmban „një keqkuptim apo ndarje të pasaktë latine në Mizinë e Poshtme [Moesia Inferior] nga **druwā-tā*, një sintagmë nominale me një nyjë të prapavendosur“ . Dhe kështu, shkruan Hampi, kemi „dëshmi të drejtpërdrejtë nga periudha romake, për një nga ndërtimet sintaktike më të shquara për Lidhjen gjuhësore ballkanike, dmth. një mostër nga gjuha autoktone e modelit të nyjës së prapavendosur të rumunishtës që ishte kalkuar nga materialet latine.“ Përveç kësaj, Hampi shkruan: „kjo është një dëshmi e drejtpërdrejt për posedimin e përbashkët të këtij tipari të rëndësishëm që e lidh gjuhën moderne shqipe me Mizinë e Poshtme.“

Nyja e prapavendosur gjithashtu është një shembull me shumë rëndësi për parimet e gjuhësisë ballkanike, sepse ajo jep një ilustrim të qartë të parimet të ashtuquajtur zgjedhje e tipareve në zhvillimin e gjuhëve në kontakt në modelin e linguistikës ekologjike (Mufwene 2001). Për këtë është rëndësi të veçantë kanë gjuhët sllave ballkanike në krahasim me gjuhët e tjera sllave. Kështu, mund të konstatojmë se në periudhën e sllavishtes së vjetër kishte edhe një shenjues për caktuarësi të prapavendosur për mbiemrat, dmth. përemri **ŷ* nga paraardhësi indoeuropian. Përveç kësaj përemri dëftor ndeshet edhe në pozicion pas emrit, megjithëse kjo nuk është e detyrueshme. Përveç kësaj kemi një farë nyje të prapavendosur në dialektet e Rusisë veriore. Por megjithatë, historia dhe distribucioni i nyjës së prapavendosur në Ballkan tregon se fenomeni i Gadishullit ballkanik është një zgjidhje konvergente dhe gjuha shqipe është lidhur me të.

Fenomenët që lidhen me përemrat dëftore janë me shumë interes për linguistikën ballkanike pikërisht sepse në krahasim me sistemet e tjera, përemrat dëftorë janë relativisht konservativë. Kështu, për shembull, sistemi indoeuropian me tri ndryshime i tipit 'afër-neutral-larg' është ruajtur në greqisht dhe në dialektet sllave në perëndim të Ballkanit, domth. torlakishte, maqedonishte perëndimore, dialektet bullgare të jugut (rhodopishte, thrakishte). Në shumës në dialektet bullgare sistemi është thjeshtësuar në dy me ruajtjen e opozicionit neutral-larg, derisa në gjuhën shqipe dhe në gjuhët romane në përgjithësi thjeshtësimi shkon në drejtim 'afër-neutral'. Mund të bëjmë edhe një vështrim: në gjuhën rome një sistem dyfish me opozicionet 'specifik/general' (-*d/k-*) dhe 'afër-larg' (-*a/o-*) jepet një sistem katërfish, për shembull *adava-akava/odova-okova* që ruhet në të gjitha dialektet rome në ballkan sidhe në afro të gjithë jashtë Ballkanit. Edhe në turqishte sistemi është trefish (*bu-şu-o*) megjithëse semantiku është e ndryshme.

Mirëpo, megjithatë, kemi raste kur ndeshet edhe ndikimi i një gjuhës në strukturën e tjetrës. E tillë është situata me Gorën e poshtme. Gorançja është një diasistem shumë interesant sepse gjendet në Kosovë (dhe në pjesën fqinje të Shqipërisë), por isoglossat më të rëndësishme e lidhen gorançen me maqedonishten (theksi, nyja, etj.). Nga pikëpamja dialektologjike, Gora ndahet më dy pjesë: Gore e epër dhe Gora e poshtme. Gora e epër është më aftër Maqedonisë derisa Gora e poshtme është në kufi me Opojën, ku të gjithë fshatrat janë shqipfolëse. Interesant është se derisa në dialektat e Gorës së epër sistemi dëftor është njëlloj si në Maqedoninë perëndimore në përgjithësi (si nga kjo pikëpamje edhe serbisht) — dmth. -*v/-/n-* (afër/netural/larg)— në Gorën e poshtme kemi një sistem të njëjtue me gjuhën shqipe — dmth. -*v/-/t-* (afër/neutral) — që patjetër vjen nga ndikimi i gjuhës shqipe (dhe më përpara edhe të gjuhës vllahe) veçanërisht kur kemi parasysh se në dialektet fqinje ruhet opozicioni i trefishtë — nga një anë — dhe se në dialektet e tjera sllave thjeshtësimi shkon në drejtimin -*t/-/n-* (neutral/larg) dhe jo -*v/-/t-* — në anën tjetër.

Këtu edhe mund të përmendim edhe dialektet maqedonase në afërsi të Korçës, në Bobshticë dhe Drenovenë, ku rasa ruhet në disa nyja të shquara të prapavendosur. Megjithëse një fenomen të tillë kemi edhe në dialektet Torlake, është e qartë se atje kemi të bëjmë me vazhdimin e kontinuum rator sllav që shkon nga veriperëndimi deri në juglindje, kurse në krahinën e Korçës kemi një arhaizëm të izoluar që ka të bëjë me ndikimin e shqipes. Është interesant se ky nuk ndodhet në fshatrat të tjera maqedonasefoljësi, p.sh. Vërniku, që është lidhur nga pikëpamja dialektologjike me fshatrat në anën tjetër të kufirit në Greqi, p. sh. Smrdesh e tj.

Ka shumë paraqitje nominale ballkanike të tjera ku gjuha shqipe zë një vend të veçantë, p. sh. përdorimi i numrit *një* si një nyjë joshquese, dëftimi dyfish i tipit *ai njeriu*, topikalizimi më një përemër në kallëzore apo dhanore (i ashtuquajtur 'reduplikimi'), dhe shumë elemente të tjera. Por këtu dëshiroj të vë në pah vetëm dy pika:

- 1) Megjithëse në linguistikën europerëndimore në vitet e fundit po bëhet përpikje për të formalizuar një teori që kombinon tipologjinë me linguistikën areale dhe sipas së cilës tërë Europa është një lidhje gjuhësore me një qendër në kufirin Romano-Gjerman nga Holanada deri në Italië veriore, dhe me Ballkanin në periferi (Haspelmath 1998, Heine & Kuteva 2006), megjithatë linguistika areale është një fushë historike—dhe nga kjo pikëpamje Ballkani është qendër me vetëveten, dhe gjuha shqipe merr një vend qendror atje.
- 2) Megjithëse disa paraqitje ballkanike janë shumë të shpërndara dhe njihen shumë mirë, në fushën e paraqitjessë mikrosistemeve aktuale ende ka shumë për t'u thënë për gjuhësinë vashtuqatur linguistika e kontakteve dhe kufiri gjuhësor shqiptaro-sllav paraqet shumë interes.

Bibliografi

- Hamp, E. 1982. The Oldest Albanian Syntagma. *Balkansko ezikoznanie* 25:1.77-79.
- Haspelmath, M. 1998. 'How Young is Standard Average European?', *Language Sciences* 20,3.271-287.
- Heine, B. & T. Kuteva. 2006. *The Changing Languages of Europe*. Oxford.
- Kopitar, J. 1829. Albanische, walachische und bulgarische Sprache. *Jahrbücher der Literatur* 46.59-106.
- Mufwene, S. 2001. *The Ecology of Language Evolution*. Cambridge.